

Sekrete të Dhimbshme

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Guxim, Solidaritet, Vetbesim, Drejtësi.

Qëllimet

Pedagogjike: Të kuptosh si të reagosh ndaj sulmeve kundrejt integritetit fizik ose psikologjik. Të kuptosh si të masësh pasojat e një sekreti. Të jesh në gjendje të besosh dhe të kërkosh për ndihmë.

Praktike: Leximi i historisë dhe eksplorimi i dilemave me të cilat përballen personazhet.

Pjesëmarrësit

Minimumi 6; Maksimumi 30

Kohëzgjatja

45 deri 60 minuta

Materialet

Fleta e aktivitetit që projektohet ose printohet dhe u shpërndahet nxënësve.

Përmbledhje

Mësuesi/ja projekton ose u shpërndan nxënësve fletët e aktivitetit. Në grupe dyshe nxënësit duhet t'u përgjigjen pyetjeve të dhëna. Në fund, çdo grup i prezanton përgjigjet klasës, ndëkohë që mësuesi/ja mund të shënojë përfundimet më të rëndësishme në tabelë.

Shënime

Në vend që të lexojë historinë, mësuesi/ja mund të sugjerojë që dy studentë ta aktrojnë atë për klasën.

Për informacione shtesë, ju lutem vizitoni faqen e internetit

www.pacerteensagainstbullying.org

Diskutimi

Për të orientuar diskutimin, mësuesi/ja mund të eksplorojë pyetjet e mëposhtme me klasën:

Sipas mendimit tuaj, çfarë është bulizmi? Cilat janë shënjat e tij?

Pse gjetët atë mënyrë për të zgjidhur dilemën e Tomas-it?

Keni qenë ndonjëherë viktimë e bulizmit apo njihni dikë që është përballur me këtë problem? Si jeni ndjerë? Çfarë keni bërë? Pse?

Çfarë mendoni se duhet bërë për të parandaluar rastet e bulizmit?



Sekrete të Dhimbshme

Fleta mbështetëse e Mësusit

Eksplorimi i Dilemave

E Vërteta kundrejt Besnikërisë

Tomas mendon se duhet t'u tregojë të vërtetën prindërve dhe mësueses së Xhonit, si edhe kushurinjeve të tij më të mëdhenj për arsyen e vërtetë se pse ai po çalon. Por, Xhoni i kërkoi atij që ta mbajë këtë si sekret dhe ata kanë qenë gjithmonë besnik ndaj njërit-tjetrit. Nëse Tomasi nuk i tregon askujt, ndoshya Xhoni mund të vazhdojë të vuajë agresionet fizike, por nëse ai tregon të vërtetën, ai mund të humbasë besimin e kushuririt të tij. Duhet Tomasi t'i qëndrojë besnik premtimeve të tij, apo e vërteta qëndron mbi gjithçka?

Drejtësia kundrejt Frikës

Xhoni e di se, ajo që nxënësit e klasës së 10-të i bënë atij është e padrejtë dhe që të sulmosh një person është një krim, prandaj ai e ndjen që ata duhet të dënohen për dëmin që e shkaktuar, qofte duke u ankuar në shkollë ose duke u kërkuar kushurinje më të mëdhenj t'i japin një mësim të mirë.

Por, nga ana tjetër, ka frikë se gjërat mund të përkeqësohen dhe të tjerët mund ta sulmojnë akoma më shumë për shkak të ankesës.

Duhet Xhoni të mbështetet te drejtësia dhe të përballojë frikën e tij, duke besuar te njerëzit që duan ta ndihmojnë atë? Apo, është më mirë që ta lëri situatën ashtu siç është dhe të mos i tregojë askujt?

Hakmarrje kundrejt Drejtësisë

Nëse kushurinjtë më të mëdhenj do t'u jepnin një mësim nxënësve të klasës së 10-të, Tomasi dhe Xhoni do të ndiheshin që kishin atë që meritonin.

Por do të ishte kjo gjëja e duhur? Nuk do të shkaktonte kjo hakmarrje më shumë konflikte midis grupeve të nxënësve?

Por, për të vendosur drejtësi në vend të hakmarrjes, Xhoni duhet t'u tregojë prindërve dhe mësuesit të tij, kështu që kushurinjtë nuk do të mund të ndihmonin shumë, por të përpiqeshin ta mbronin atë.

Afatshkurtër kundrejt Afatgjatë

Xhoni mund të mërzhitet nëse Tomasi i tregon të tjerëve çfarë ndodhi dhe madje agresorët mund ta kërcënonin atë më tepër për shkak të ankesës.

Por, nëse Xhoni do që kolegët e tij të dënohen, ai do ta ndjejë që drejtësia u vu në vend dhe që ata nuk do të mbeten pa u ndëshkuar për të keqen që shkaktuan. Në kohën kur gjërat do jenë harruar, Xhoni do të jetë në gjendje të kuptojë më mirë pse Tomasi i tregoi të tjerëve duke e falur atë për mungesën e besnikërisë.



Sekrete të Dhimbshme

Fleta e nxënësit

Ngjarja

Xhoni dhe Tomasi janë kushurinjtë dhe shok shumë të ngushtë, por ata shkojnë në shkollë të ndryshme dhe e takojnë njëri-tjetrin vetëm në fundjavë. Xhoni është në klasën e 8-të dhe është turpvogël për moshën e tij, madje edhe mamaja e tij thotë vazhdimisht që ai nuk është rritur shumë sepse nuk kishte ngrënë mjaftueshëm spinaq ☺ dhe krahët e tij janë shumë të hollë dhe pa muskuj. Xhoni nuk ka qejf të luajë futboll dhe zakonisht lexon në fushën e lojës dhe nxënësit e tjerë të shkollës tallen me të.

Tomasi, i cili është dy vjet më i madh, luan futboll dhe përfshihet shpesh në zënka, por ai ka miqësi shumë të mirë me Xhonin, sepse Xhoni di gjithmonë përgjigjen e duhur për çdo gjë dhe i tregon atij histori të mrekullueshme.

Një të djetër, kur ata u takuan në shtëpinë e xhaxhait të tyre, Tomasi vuri re se Xhoni po çalonte dhe e kaloi gjithë drekën duke parë nga pjata e tij. Kur ishin të dy vetëm, ai e pyeti atë se çfarë kishte ndodhur dhe Xhoni u përgjigj: - Ti duhet të betohesh në fillim që nuk do t'i tregosh askujt.

Tomasi ngriti supet dhe u përgjigj: - Të betohem, por më trego se çfarë ka ndodhur?

- U kam thënë prindërve që kam rënë nga shkallët e shkollës, por e vërteta është se disa çuna nga klasa e 10-të më rrahën.

Pastaj Xhoni filloi të qajë me lotë të mëdhenj që i zbrisnin nëpër faqe.

Tomasi ishte shumë i inatosur, sa që sytë po i nxirrnin xixa nga inati:

- Ah, ata çuna... Ti nuk duhet të rrish i heshtur, duhet t'u tregosh prindërve, mësuesit tënd....

- Nuk mundem, nuk mundem Tomas, pastaj ata do më quajnë ankues dhe është më keq... - Atëherë do u them kushurinjtë tanë më të mëdhenj që t'i japin një mësim të mirë...

Xhoni bërtiti:

- U çmende, Tomas! Ti u betove që nuk do tregosh asgjë! Prandaj të tregova. Nëse ti shkon dhe u tregon, ata do të më vrasin fare herën tjetër. Në qoftë se nuk do më kenë vrrarë deri atëherë – tha ai me ngashërim.



Sekrete të Dhimbshme

Fleta e nxënësit (vazhdimi)

1. Sipas mendimit tuaj, çfarë është e drejtë, e gabuar ose as e drejtë e as e gabuar në këtë histori? Argumentoni përgjigjet tuaja.

Është e drejtë _____
sepse _____.

Është e gabuar _____
sepse _____.

Nuk është as e drejtë as e gabuar _____
sepse _____.

2. Midis mundësive të mëposhtme cilat janë dilemat që ju i konsideroni si më të rëndësishme në këtë histori? I rendisni ato nga 1 deri në 4 nga më e rëndësishmja te ajo më pak e rëndësishme.

- E vërteta kundrejt Besnikërisë
- Drejtësia kundrejt Frikës
- Hakmarrje kundrejt Drejtësisë
- Afatshkurtër kundrejt Afatgjatë

2.1 Argumento mendimet e tua:



Sekrete të Dhimbshme

Fleta e nxënësit (vazhdimi)

3. Sipas mendimit tënd, çfarë mund të ndodhë nëse Tomasi:

E bind kushuririn e tij që tu tregojë prindërve? _____

Respekton dëshirën e tij dhe nuk i tregon askujt? _____

I tregon kushurinjtë të tyre më të rritur? _____

4. A ka alternativa të tjera për të zgjidhur problemin e Tomas-it? Cilat janë ato?

5. Nëse Tomasi do ta vinte veten në vëndin e të tjerëve çfarë do të bënte?

Nëse do të ishte Xhoni, do të _____

Nëse do të ishte babai i Xhonit, do të _____

Nëse do të ishte mamaja e Xhonit, do të _____

Nëse do të ishte një nga kushurinjtë e tij më të mëdhenj, do të _____

6. Bazuar në përgjigjet e mëparshme, shkruani një tekst se si duhet të përfundojë historia e Tomasit dhe Xhonit.

